



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 821/4 Prot.

Vlorë, më 01.07.2019

VENDIM

Nr. 27, datë 01.07.2019

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT
"MASTER I SHKENCAVE NË MENAXHIM TRANSPORTI INTERMODAL"**

Mbështetur në nenin 75, pikën 7 të nenit 25, shkronjën **dh**, pika 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 01.07.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Shkencave Detare për program të ri studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave në menaxhim transporti intermodal".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

